



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr.02/L-26, nenit 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 i datës 27.12.2006 dhe neneve 15.2 shkronja d dhe 19 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2016, miratoi,

VENDIM

PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Kadri Lutfi Muçolli nga fshati Bajçinë Komuna e Podujevës, në cilësinë e pronarit, i lejohe ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 1376-1 kultura – bujqësore - arë kl. 2, vendi i quajtur Stupe-Te plepat në sipërfaqe prej 2000 m² certifikata pronësore nr. 08/095/22997 e datës 21.03.2016, Zona Kadastrale Bajçinë.

Neni 2

Pronari, në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzojë vetëm për ndërtimin e fabrikës së peletit dhe nuk mund ta përdorë për qëllime të tjera.

Neni 3

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtorja e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtorja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-26553

Podujevë,

30 mars 2016



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
 SHËRBIMEVE PUBLIKE/ MINISTARSTVO JAVNIH SLUZHBI/ MINISTRY OF PUBLIC SERVICES

KUVENDI KOMUNAL SKUPSTINA OPSTINA MUNICIPALITY
 P O D U J E V Ë - O

KOPJE PLANI-A

DREJ.PËR GJEOD.KADA.&PRONË/UPR. ZA GEOD.KATI.SVOI/DEP.FOR GEO.CADA&PROPERTY
 Z.Kadastrale/K .Zona/Municipal Zon BAJQINË Shk.Zv/Razmera/Apr .Gra: P=1:1000

Pronari/Posehnik/Possesion MUÇOLLI KADRI (LUTFI)1/1



NR rend I taksave/Redni br.taks/Number takse Ësht kopje e origji, të vitit/ Kopia orgin.stanj god./Original copy yers

Ngastra Parcela Parcel	Kultura Kultura Cultu. name	Klasa Klasa Class	Vendi I quajtur Zvano mesto Place name	Sip/Pove/Area			Vërejtje Napomena Notice
				ha	ar	m	
1376-1	are	2			20	00	



Podujevë 21.03.2016

Punoi/Izradio/Work

tori/Direktor/Director

Luçaliu